



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 40/11
Prishtinë, më 09.12.2011, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj dhe Hasime Krasniqi.

Munguan: Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje dhe Albana Fetoshi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Memli Krasniqi, Ministër i KRS, Ferki Fejza, Shefi ekzekutiv i AKMRSB, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami dhe Juergen Schatz-GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave me raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport me raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
I ftuar: Memli Krasniqi - Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime Këshilluese me raportin me amendamente të komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-67 për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore me raportin me amendamente të komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor;**

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-72 për Kontrollin dhe Mbikëqyerjen e Kufirit Shtetëror me raportin me amendamente të komisionit funksional Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së;**
7. **Të ndryshme**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave me raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Kryetarja, propozoi që ti rekomandohet komisionit funksional për të ndryshuar paragrafin 3 dhe 4 të Nenit 12, që ka të bëjë me orarin e plotë të punës për kryetarin dhe nënkryetarin e KPM-së.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

1. Projektligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 12, paragrafi 3 dhe paragrafi 4. Komisioni për Buxhet dhe Financa, i rekomandon komisionit funksional, që në nenin 12. paragrafi 3, të fshihet teksti “orari i plotë i punës”, për shkak të obligimeve buxhetore shtesë që krijohen në rast se mbetet që kryetari dhe nënkryetari i KPM-së të punojnë me orar të plotë të punës në KPM. Njëkohësisht Komisioni rekomandon që në paragrafin 4 të nenit 12, që të fshihen fjalët “tjerë të”, që duhet të jenë si rrjedhojë e ndryshimeve, që janë rekomanduar të bëhen në paragrafin 3, të nenit 12.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport me raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Kryetarja, theksoi që amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, mirëpo sipas deklaratës financiare nga Ministria e Financave, Projektligji në përgjithësi përmban implikime buxhetore.

Memli Krasniqi, u pajtua me faktin që deklarata financiare që ka ardhur nga Ministria e Financave është e papërbalueshme, mirëpo kjo deklaratë financiare nuk është e saktë dhe është deklarata e tretë që bëhet për këtë Projektligj. Deklarata e parë ka pasur vlerësim minimal për implikime buxhetore, deklarata e dytë ka qenë krejtësisht e pa formuluar dhe deklarata e tretë më tepër është e paramenduar se sa e bazuar në shpenzimet reale. Komiteti Olimpik i Kosovës, parashihet të financohet përmes subvencioneve nga Buxheti i Kosovës deri në momentin kur do të bëhet anëtar i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Këshilli i Arbitrazhës dhe Gjykata e Arbitrazhës nuk janë sistem organesh të përhershme, sepse funksionojnë pa kompensim dhe ekzistojnë vetëm në rastet kur mund të ketë një kontest brenda një Federate dhe atëherë mund të bëjnë ankesa. Sa i përket sistemit të bursave, theksoi

që edhe nëse do të ekzistonte sistemi i bursave olimpike i ngjashëm me ato që janë në rajon prej 150 - 200 € në muaj, atëherë do të kemi një implikim buxhetor që nuk do të tejkalojë shumën prej 10.000 € gjatë gjithë vitit. Lidhur me pensionet e sportistëve të dalluar sqaroi se kjo çështje nuk është paraparë për shkak të gjendjes në të cilën ndodhet vendi jonë. Agjencia për Luftë Kundër Dopingut është përfshirë në legjislacion, sepse është kriter themelor për t'u pranuar në instancat ndërkombëtare sportive, siç është Komiteti i Olimpik Ndërkombëtar dhe Organizata Botërore Kundër Dopingut dhe duhet të themelohet vetëm formalisht. Mirëpo ajo që shkruan në deklaratë se kjo agjenci duhet të ketë një staf prej shtatë zyrtarëve nuk është e vërtetë, sepse këtë numër të zyrtarëve nuk e ka as Komiteti Olimpik i Kosovës.

Muhamet Mustafa, theksoi që konsolidimi i sporteve ka një rol shumë të madh për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës dhe inkurajoi Ministrin që menjëherë të krijohen mekanizma për zbatimin e këtij ligji. Sa i përket implikimeve buxhetore, arsyetimet e Ministrit janë racionale dhe sugjeroi që brenda buxhetit ekzistues të realizohen këto shpenzime që implikohen në këtë ligj. Pyeti se a është zgjidhur çështja e bizneseve të cilat japin kontribute për klube apo federata që të lirohen nga obligimet tatimore.

Sali Asllanaj, përkrahu këtë ligj, edhe në rastin nëse do të kishte pasur implikime më të mëdha buxhetore do ta kishte përkrahur, sepse Kosova është një shtet i të rinjve dhe duhet të bëhet racionalizim brenda shpenzimeve. Sugjeroi që të punohet më shumë në këtë drejtim.

Hykmete Bajrami, theksoi se pavarësisht nivelit të saktësisë së Deklaratës Financiare që ka ardhur nga Ministria e Financave, ky është një dokument legjitim në të cilin anëtarët e komisionit bazohen. Prandaj, nuk mund të miratohet ky Projektligj me një deklaratë të tillë financiare. Duhet të bëhet një sqarim ndërmjet dy ministrive se sa do të kushtojë implementimi i këtij ligji.

Latif Gashi, rekomandoi që të aprovohet projektligji, pasi që nga arsyetimet e Ministrit shihet që projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Hasime Krasniqi, i konsideroi bindëse arsyetimet e Ministrit lidhur me ndikimet buxhetore të projektligjit dhe besoi që projektligji do të jetë i aplikueshëm në praktikë.

Kryetarja, sqaroi se në neni 31 të projektligjit që i referohet plotësimit të nenit 83.3 të ligjit në fuqi, thuhet se institucionet e ndikuara në këtë ligj, sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit i përmbushin obligimet e tyre. Sipas këtij neni, qdo implikim buxhetor, duhet trajtuar në bazë të buxhetit vjetor, të lejuar për institucionet që ndikohen.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime Këshilluese me raportin me amendamente të komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-67 për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore me raportin me amendamente të komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit që në grupin punues së bashku me deputeten Hykmete Bajrami e kanë pasur një kërkesë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore të figurojë si program i veçantë në kuadër të Ministrisë. Mirëpo, me këtë projektligj parashihet që të formohet ky agjencion i shkëputur nga Ministria dhe të zgjidhet nga Kuvendi, me ç'rast prodhon implikime të shumta buxhetore. Në grupin punues është vendosur që ky agjencion të kalojë si program i veçantë në kuadër të Ministrisë dhe të shtohen edhe dy punëtorë të ri, së bashku me buxhetin për paga për këta punëtorë si dhe t'i caktohet paga kryeshefit ekzekutiv sipas të gjithë kryshefave të ekzekutivit. Propozoi që ky projektligj të kthehet dhe të mbahet një takim i përbashkët me komisionin funksional për të analizuar arsyeshmërin e agjencionit.

Ferki Fejza, sqaroi që agjencioni është themeluar në Qershor të vitit 2011 dhe aktualisht i ka vetëm tre të punësuar, kryeshefi ekzekutiv dhe dy zyrtarë të tjerë që janë transferuar nga departamenti i mjedisit dhe janë me profesion kimista. Ky agjencion nuk mund të funksionalizohet me kuadro që nuk janë profesionale. Është paraparë që agjencioni fillimisht të funksionalizohet me dy departamente: Departamenti për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore dhe Departamenti për Licencim dhe Inspektim. Projektligji është bazuar në Direktivat Evropiane dhe në dokumentin bazik të principeve të mbrojtjes prej rrezatimit dhe sigurisë bërthamore. Sipas këtij dokumenti thuhet që agjencioni duhet të jetë i pavarur ndaj departamenteve qeveritare, për shkak të sigurimit të vendimmarrjes profesionale dhe shmangies së ndikimeve politike.

Latif Gashi, pyeti sa punëtorë i kërkon agjencioni sipas projektligji? Shprehu vërejtje për agjencionet në kuadër të ministrive të cilat kërkojnë të pavarësohen dhe propozoi që projektligji të kthehet dhe agjencioni të vazhdojë punën ashtu siç ka qenë deri më tash në kuadër të ministrisë, vetëm se duhet të plotësohet me kuadro profesionale.

Ferki Fejza, sqaroi se në vitin e parë është paraparë t'i ketë 17 punëtorë, mirëpo mund të bëhen edhe shkurtime minimale deri në 10 punëtorë.

Sali Asllanaj, theksoi që gjatë formimit të agjencioneve, ato duhet të kompletohen dhe të kërkohet përgjegjësi për punën e tyre dhe propozoi që ky të jetë agjencion pranë Qeverisë, e jo pranë Kuvendit.

Xhevdet Neziraj, theksoi që ky është një agjencion mjaft i rëndësishëm, mirëpo sa do të ketë Kosova mundësi të ofrojë kuadro për të funksionalizuar këtë agjencion. Nevojitet një përgatitje më e mirë, sepse kjo është një çështje specifike.

Hasime Krasniqi, përkrahu mendimin që ky agjencion të funksionojë në kuadër të ministrisë, sepse këto janë mundësitë dhe kushtet në të cilat gjendet Kosova. Ajo çka nevojitet janë vetëm kuadrot profesionale.

Muhamet Mustafa, nuk e përkrahu formimin e agjencionit nga Kuvendi, sepse ka ardhur koha që të analizohen se cilat agjencione do të mund të ktheheshin në kuadër të ministrive. Mund të lejojmë 2-3

ekspertë të lëmisë përkatëse me studimet postdiplomike, mirëpo duhet të ndalohet ngarkimi i buxhetit me shifra më pak të rëndësishme.

Kryetarja, thekso se

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Projektligji nr. 04/L-67 për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, përmban implikime buxhetore shtesë. Komisioni për Buxhet dhe Financa, vlerëson se dispozitat e këtij projektligji që rregullojnë krijimin e Agjencisë si organ të pavarur, drejtorin dhe buxhetin e të cilit parashihet të caktoj Kuvendi, krijojnë obligime buxhetore shtesë, që nuk janë të parapara në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për 2012-2014.
- II. I rekomandohet Komisionit funksional, të mos e procedojë projektligjin për miratim në Kuvend, dhe propozon që të mbahet një takimi i përbashkët në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe komisionit funksional, për të harmonizuar qëndrimet lidhur me dispozitat e këtij projektligji, që vlerësohet se përmbajnë implikime buxhetore, dhe që e bëjnë të pazbatueshëm ligjin në praktikë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-72 për Kontrollin dhe Mbikëqyerjen e Kufirit Shtetëror me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje tjetër për të diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj